

posta



PK. SH.A.
Posta e Kosovës SH.A.
Post of Kosovo J.S.C.
Pošta Kosovo D.D.

Nr./No./Br. 01-1860/24
Data/Date/Datum 31-07-2024
PRISHTINË-PRISTINA-PRISTINA

RREGULLORE PËR PROCEDURË DOGANORE NË TRAFIKUN POSTAR

H.M



Ndërmarrja Publike Qendrore
POSTA E KOSOVËS SH.A.

Në bazë të nenit 20 të Ligjit Nr-04/L-111 për Ndryshim dhe Plotësimin e Ligjit Nr-03/L-087 për Ndërmarrje Publike, Ligjit Nr-06/L-016 për Shoqëri Tregtare Bazuar në nenin 52,53 dhe 54 të Ligjit për Shërbimet Postare nr.06/L-038, Rregullores për autorizimin e përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve postare nr.pot.041/B/19 nr. i regjistrit: 41 – ARKEP shtojca III- neni 3 paragrafi 3.10 dhe neni 16 paragrafi 2, Rregullores për ofrimin e shërbimit universal nr.prot.123/B/2019, nr. i regjistrit:44 neni 15 paragrafi 8, neni 24 paragrafi 6 të Termave dhe Kushteve për kryerjen e shërbimeve universale postare, nr.03-528/2021 dt. 25.02.2021, neni 27 paragrafi 6 të Termave dhe Kushteve për kryerjen e shërbimeve tjera postare, dt. 10.09.2020, dhe Udhezuesit për procedurën doganore në trafikun postar me Postën e Kosovës nr.01/330/2024 dt.29.03.2024, dhe Bordi i Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike Qendrore Posta e Kosovës Sh.A. sipas vendimit nr.56 me datë 30.07.2024, aprovon këtë:

RREGULLORE PËR PROCEDURË DOGANORE NË TRAFIKUN POSTAR

Neni 1.

Dispozitat dhe termat e përgjithshme

1.Kjo Rregullore përcakton procedurën doganore në lidhje me dërgesat postare në trafikun postar ndërkombëtar (në tekstin e mëtejme: dërgesat postare), të cilat lëshohen në qarkullim të lirë ose deklarohen për procedurë tjetër doganore ose përdorim në territorin doganor të Republikës së Kosovës.

2.Në trafikun postar ndërkombëtar, dërgesat postare transportohen përmes rrugëve tokësore (rrugore dhe hekurudhore) SAL (Det, Ajër dhe Tokë) dhe ajrore.

3. Pranimi i dërgesave postare nga jashtë, dërgimi i tyre jashtë vendit, bartja e dërgesave ndërmjet Doganës dhe pranuesit – Postës së Kosovës Sh.A., si dhe çdo veprim tjetër që kryhet në kuadër të procedurës doganore me dërgesat postare në trafikun postar ndërkombëtar, kryhet nën mbikëqyrje doganore dhe në zbatim të masave të kontrollit doganor, sipas dispozitave të Kodit Doganor dhe Akcizave nr. 08/L-247, Udhëzimit Administrativ për dispozitat zbatuese nr.11/2009 i ndryshuar, Ligjit për Shërbimet Postare nr. 06/L-038, marrëveshjeve ndërkombëtare doganore dhe postare, gjegjësisht akteve të Unionit Universal Postar, rregulloreve të tjera dhe kësaj Rregulloreje.

4. Mbikëqyrja doganore përfshin masat që nënkuptohen për të parandaluar trajtimin e paautorizuar të mallrave doganore dhe për të siguruar gjendjen faktike të tyre, deri në përfundim të procedurës doganore të parapara me Kodin Doganor dhe të Akcizave nr. 08/L-247.

5. Dërgesat postare, të cilat përmbajnë para, letra me vlerë dhe ari në formë të përpunuar ose të petëzuar, do t'i nënshtrohen edhe kontrollit të këmbimit valutor në përputhje me dispozitat që rregullojnë afarizmin valutor.

Neni 2.

Termet e përdorur në këtë Rregullore kanë këto kuptime:

1. Trafiku postar ndërkombëtar - qarkullimi i dërgesave postare ndërmjet një operatori postar të autorizuar të një shteti dhe një operatori postar të autorizuar të një ose më shumë shteteve;

2. Postë e jashtme – dërgesat postare, të cilat arrijnë në PK Sh.A. nga administratat e pranuar postare në UPU dhe operatorë tjerë postarë të licencuar.

3. Qendra Transite Postare – Departamenti i veçantë i operatorit publik postar, në të cilën kryhen operacionet e arritjes, sortimit dhe dërgimit të të gjitha llojeve të shërbimeve të letër postës, dërgesave EMS, thasëve "M", postës Express dhe koli postës, ndërmjet administratave postare botërore me transit të hapur dhe këmbim të mbyllur, si dhe në mes të zyrave postare brenda territorit të Republikës së Kosovës.

- Sektori i koli postës - pjesë organizative e postës transit që kryen detyrat e pranimit, sortimit dhe dërgimit të kolive postare, si dhe ndërmjetësimin e thasëve me koli në trafikun postar ndërkombëtar;

- Sektori i letër dërgesave - pjesë organizative e Qendrës Transite që kryen detyrat e pranimit, sortimit dhe dërgimit të letër dërgesave postare, dërgesave Express dhe EMS, si dhe ndërmjetësimin të thasëve postarë në trafikun postar ndërkombëtar;

4. Sektori doganor - pjesë organizative e operatorit publik postar (PK) në QTP që kryen detyrat e dorëzimit të dërgesave postare në trafikun postar ndërkombëtar për kontroll doganor;

5. Dogana e Kosovës/Zyra Doganore :

- Zyra Doganore kompetente (**Posta Doganore - QTP**) dhe strukturat e saj organizative përgjegjëse për zbatimin e dispozitave doganore dhe dispozitave të tjera, si dhe procedurat që kryhen në trafikun postar ndërkombëtar;
- Zyra e nisjes - autoriteti doganor në të cilin fillon procedura e transitit ose një procedurë tjetër doganore;
- Zyra e destinacionit – zyra doganore në të cilën kryhet procedura e transitit ose ndonjë procedurë tjetër doganore.

6. Transiti:

- Transit i hapur – dërgesa postare, të cilat për operatorin postar të origjinës përpunohen nga një operator postar i ndërmjetëm për dërgim në destinacion të fundit.
- Transit i mbyllur – dërgesa postare, të cilat këmbehen me këmbim të mbyllur të thasëve në mes të operatorit postar të origjinës dhe atij të destinimit të fundit.

- 7. Dërgesë (thes) postare** - dërgimi i njëhershëm i dërgesave postare në thasë, kontejnerë, paleta dhe të ngjashme, për të cilat plotësohen dokumentet postare të përcaktuara. Dërgesa mundet të përbëhet nga një ose më shumë thasë me dërgesa postare dhe mundet të përmbajë letra, koli dhe dërgesa EMS (Shërbim Postar Ekspres i Jashtëm).
- 8. Lista e këmbimit** - dokumenti i cili për thasët me letra, paketa dhe EMS që plotësohet dhe dorëzohet në Zyrën Doganore nga posta transite kompetente, përkatësisht posta e zhdoganimit dhe i bashkëngjitet thesit.
- 9. Dërgesat CONSIGNMENT** (dërgesa postare me shumicë - grupimi i dërgesave) - mbërritja ose dërgimi i një numri të madh dërgesash postare të dërguara nga një dërgues, për një ose më shumë marrës.
- 10. Dokument unik doganor (DUD)** – dokument me të cilin në procedurë të rregullt llogaritet borxhi doganor për dërgesat postare të pranuar nga personi juridik në Republikën e Kosovës.
- 11. T1** – dokument doganor, i cili plotësohet në pikën kufitare me rastin e hyrjes së dërgesave postare.
- 12. CN22** – deklaratë doganore, e cila si formular postar ndërkombëtar në formë të etiketës, plotësohet nga dërguesi për dërgesat me letra dhe dërgesat EMS në vlerë totale deri në 300 SDR.
- 13. DTS** – njësi monetare, në të cilën të gjitha vendet i llogarisin vlerat e caktuara të valutës nacionale dërgesat postare në trafikun ndërkombëtar.

14. **CN23** - deklaratë doganore, të cilën si formular postar ndërkombëtar e plotëson dërguesi i një dërgese postare që përmban mallra doganore dhe në bazë të së cilës dërgesat postare në import dhe eksport vendosen nën procedurën e duhur doganore, kur kjo mund të aplikohet.
15. **CN24** - formulari postar ndërkombëtar, në të cilin operatori kompetent publik postar përpilon procesverbalin për parregullsitë, nëse konstatohen parregullsi të caktuara në lidhje me dërgesat postare.
16. **CN13** – procesverbali si njoftim për konfiskimin e dërgesës.
17. **CN37, CN38** – Lista të këmbimit.
18. **CP71** – fletëdërgesa.
19. **CP72** – deklarata doganore/fletëdërgesa.
20. **CP78** – njoftimi në lidhje me parregullsitë për kolutë në postën transitore kur dallon pesha e kolisë apo dëmtimi i saj.
21. **ASYCUDA** – sistem i automatizuar ndërkombëtar i të dhënave doganore.
22. **MANIFESTI** – dokument i Doganës së Kosovës, në të cilin përmbledhen të dhënat që përmbajnë informata lidhur me adresën, përmbajtjen dhe vlerën e faturës së dërgesës postare.
23. **Dërgesat EMS (Express Mail Service)** - dërgesat urgjente, të cilat dorëzohen me nënshkrim të marrësit dhe për të cilat dërguesi e merr vërtetimin për pranim të dërgesës.
24. **PKK**- Pika kufitare e Kosovës.
25. **SASP** - Sistemi i Automatizuar i Sporteleve Postare.

Neni 3.

IMPORTI I DËRGESAVE POSTARE

1. Dërgesat postare arrijnë nga jashtë vendi, si dhe dërgohen jashtë vendit në thasë postarë me këmbime direkte dhe me transit të hapur. Pranim-dorëzimi i dërgesave postare ndërmjet administratave postare bëhet nën mbikëqyrjen dhe kontrollin doganor.

2. Hapësirat për kontrollin dhe zhdoganimin e dërgesave postare sigurohen nga operatori publik postar "Posta e Kosovës".

3. Dogana e Kosovës, respektivisht Zyra Postare Doganore do të caktojë masat e sigurisë, si dhe procedurën për të siguruar kontroll efikas të dërgesave dhe masat për mbikëqyrjen e dërgesave postare që duhet kontrolluar dhe që janë kontrolluar.

3.1. Lista para arritjes

1. Operatori publik postar - Posta e Kosovës duhet që përmes sistemeve elektronike të dorëzojë listën para arritjes së dërgesave (nëse lista para arritjes u dërgohet nga postat e jashtme) te Zyra Postare Doganore.

2. Posa të përmbushen kushtet që Posta e Kosovës të bëjë ndërlidhjen e SASP ASYCUDA me mailbox GXS dhe PNET, në të cilat kanë qasje të gjitha autoritetet postare për këmbim të mesazheve elektronike EDI (Electronic Data Interchange), do të mundësohet transferi i të dhënave paraprake elektronike për përmbajtjen e dërgesave postare dhe do të identifikohen dërgesat me rrezik të lartë.

3. Lista para arritjes do tu bëjë të mundur zyrtarëve doganorë që të bëjnë analizën dhe profilizimin e riskut para se dërgesat të arrijnë në zyrën e destinimit, përmes të cilit mundësohet krijimi i një sistemi të avancuar që identifikon dërgesat me rrezik të lartë, duke lejuar Doganën të përqendrohet te këto dërgesa dhe të reduktojë vonesat për dërgesat me rrezik të ulët.

3. 2. Deklarimi i dërgesave postare pranë autoritetit kufitar doganor të hyrjes

1. Dërgesat postare që dorëzohen në kufi nga administratat tjera tek Posta e Kosovës në rrugë tokësore bëhet me formularin postar CN37.

2. Punonjësit e Postës duhet të procedojnë T1 në hyrje, ku përfshihen të dhënat e formularit CN37 – Listës së këmbimit që janë obligative me rastin e përpilimit të T1.

Me rastin e procedimit të T1, punonjësi i Postës duhet të bashkëngjet listën e këmbimit CN37 apo CN38 në ASYCUDA.

3. Procesimi i T1 në hyrje duhet të plotësohet para se mjeti i transportit me dërgesat postare të arrijë tek zyrtarët doganor në PKK.

4. Zyrtari i Doganës në kufi vendos pllumçën në mjetin e transportit dhe numrin e pllumçeve e përshkruan në T1.

5. Zyrtari i Doganës, me rastin e vendosjes së numrit të pllumçeve në T1, konform Kodit të Doganave dhe Akcizës, si dhe udhëzimeve administrative, e përcakton kohën e nevojshme brenda së cilës mjeti i transportit me thasët me dërgesa postare do të paraqitet në zyrën e destinimit.

6. Zyrtari i Doganës nuk duhet të lejojë kalimin e mjetit të transportit me thasët dhe dërgesat postare, nëse për të njëjtin nuk është përpiluar/hapur T1 nga Posta e Kosovës.

7. Dokumenti CN37 apo CN38 vuloset nga zyrtari i doganës në kufi dhe një kopje e këtij dokumenti dhe dokumente të tjera që i disponon punonjësi i Postës me rastin e paraqitjes së thasëve me dërgesat postare në kufi duhet të ruhet nga Zyra Doganore.

3.3. Procedura në rast se ka pasaktësi të thasëve të pranuar

1.Nëse gjatë pranimit të thasëve nga posta në ardhje në kufi konstatohet se thasët apo kolitë jashtë thesi janë të dëmtuara ose me defekt, nga punonjësit e Postës së Kosovës bëhet një procesverbal për pasaktësinë, apo konstatohet një parregullsi në Listën e këmbimit. Procesverbali ose shënimi në Listën e këmbimit duhet të vërtetohet edhe nga Zyra Doganore Kufitare e hyrjes, e cila mban një kopje të procesverbalit bashkë me Listën e këmbimit.

2.Thesi ose kolia e dëmtuar vendoset në një thes të ri, i cili mbyllet (i vendoset pllumçe) dhe së bashku me një kopje të Procesverbalit për pasaktësinë e thesit, dërgohet në zyrën postare transite kompetente, e cila do të hapë thesin (qesen) e dëmtuar dhe do të kontrollojë se çka përmban.

3.Nëse gjatë marrjes së thasëve që vijnë nga jashtë, konstatohet mungesë ose tepricë të thasëve ose kolive, posta që merr thasët kryen korrigjime në listën e këmbimit dhe raporton mungesën ose tepricën e konstatuar të thasëve apo paketave pranë Zyrës Doganore.

3.4. Transporti nga Pika Kufitare e Kosovës (PKK) deri në zyrën e destinimit QTP/Postën Doganore

1.Të njëjtat rregulla, të cilat vlejné për të gjitha mallrat dhe dërgesat që hyjnë në Kosovë përmes transportit/rrugëtimit nga PKK deri në Zyrën e Destinimit – QTP/Postën Doganore, vlejné gjithashtu edhe për T1 dhe dërgesa postare.

2.Nëse për arsye të rrethanave të ndryshme të justifikueshme, të përcaktuara me aktet në fuqi, nuk mund të arrihet në kohën e caktuar në T1 nga PKK e hyrjes, për të arritur në Zyrën e Destinimit, duhet të njoftohet menjëherë Dogana e Kosovës - Zyra e Destinimit apo PKK e nisjes.

3.Rregullat e T1 që vlejné për të gjitha llojet e importeve sa i përket përgjegjësisë kundërvajtëse për shkak të vonesës nga zyra hyrëse në zyrën e destinimit, vlejné edhe për Postën e Kosovës.

4.Pllumçet e vendosura në asnjë rrethanë nuk guxojné të dëmtohen apo të largohen, vetëm zyrtarët e autorizuar doganor mund të bëjnë largimin e pllumçeve.

5.Heqja apo largimi i pllumçeve, bazuar në dispozitat në fuqi të Kodit Doganor dhe të Akcizave, nga personat e paautorizuar përbën vepër penale.

3.5. Arritja e mjetit të transportit me dërgesat postare në QTP/Zyrën e Postës Doganore

1.Zyrtari doganor në Postën Doganore do të bëjë krahasimin e pllumçes së përshkruar në dokumentin shoqërues (listën e këmbimit CN37/CN38) me pllumçen që është e vendosur në mjetin e transportit.

2.Shikohet pllumçe nëse është në rregull dhe e paprekur, dhe pastaj ajo largohet nga mjeti i transportit.

3.Krahasohet numri i thasëve nga dokumenti shoqërues i dërgesave – Lista e këmbimit të Postave të Jashtme a përputhet me numrin e thasëve brenda mjetit të transportit;

4.Udhëzohen zyrtarët e QTP-së që të dërgojné thasët brenda qendrës/hapësirës për ekzaminim.

3.6. Procesimi i manifestit nga punonjësit e Postës

- 1.Punonjësit e Postës të autorizuar në cilësinë e agentit doganor do të bëjnë plotësimin e manifestit të dërgesave postare që përcillet me T1 në hyrje.
- 2.Plotësimi i manifestit do të bëhet përmes dokumentit XML që do të pranohet nga postat transite apo dërguese në Postën e Kosovës. Në manifest do të inkorporohen të dhënat për secilën dërgesë që përmban mallra, përfshirë edhe ato nën vlerën 35 euro.
- 3.Derisa Posta e Kosovës nuk pranon dokumentin në XML nga postat e tjera, procesimi i manifestit do të bëhet në mënyrë manuale nga punonjësi i autorizuar i Postës/agjenti doganor dhe në manifest do të inkorporohen të dhënat vetëm për dërgesat që ndalen në Doganë, për të iu nënshtruar procedurës së doganimit.
- 4.Në manifest duhet të plotësohen të dhënat për secilën dërgesë, të cilat janë obligative për procesimin e manifestit, e që janë të përcaktuara me dispozitat në fuqi.
- 5.Posa të përmbushen kushtet e qasjes në sistemet globale të transferit të të dhënave në mes të operatorëve publik postarë, do të fillojë plotësimi i manifestit përmes XML.
- 6.Posta e Kosovës është e orientuar që të aplikojë metoda të reja të gjurmimit dhe monitorimit të dërgesave postare, për të siguruar që çdo dërgesë të jetë e gjurmueshme nga pika e nisjes deri në destinacionin përfundimtar, si nga dërguesi ashtu edhe nga pranuesi. Do të fillojë së aplikuari sistemi RFID (Radio Frequency Identification), i cili i referohet një sistemi me valë të përbërë nga dy komponentë: etiketat dhe lexuesit. Lexuesi është një pajisje që ka një ose më shumë antena që lëshojnë valë radio dhe marrin sinjale nga etiketa RFID dhe GPS (Global Positioning System) që është një sistem navigimi që përdor satelitë, një marrës dhe algoritme për të sinkronizuar të dhënat e vendndodhjes, shpejtësisë dhe kohës për rrugëtimin e një dërgese postare.

Neni 4.

PROCEDURA NË POSTËN TRANSITORE/QTP

4.1 Ekzaminimi dhe ndarja e dërgesave në postën transit

4.1.1. Dërgesat e letrave

- 1.Para se të hapen thasët duhet të vendosen në X-ray për skanim.
- 2.Nën mbikëqyrje doganore, në postën transit hapen thasët postarë, pas së cilës ndahen dërgesat postare që përmbajnë ose supozohet se përmbajnë mallra që i nënshtrohen ekzaminimit doganor.
- 3.Nëse gjatë hapjes së thasëve me dërgesa postare konstatohet se dërgesa që përmban këto mallra është e dëmtuar dukshëm d.m.th. se nuk kemi qasje në përmbajtje, sektori i Postës Doganore do të bëjë një raport për dëmtimet në formularin CN 24 (Akti i Unionit Postar Universal - Pekin 1999, Bern 2009), të cilin e nënshkruajnë punëtorët e Postës dhe një zyrtar i autorizuar i Doganës. Një kopje të procesverbalit e mban Zyra Doganore.
- 4.Dërgesat ekzaminohen një nga një, pjesa dërmuese e tyre edhe hapen fizikisht për të parë përmbajtjen e dërgesës.
- 5.Nëse kërkohet nga zyrtari doganor, dërgesa postare duhet të ri-peshohet nga zyrtari i Postës përpara hapjes dhe pesha e përcaktuar të krahasohet me të dhënat nga deklarata postare

doganore. Pas kësaj, punonjësi i Postës hap me kujdes dërgesën, heq pjesë të caktuara të përmbajtjes dhe ia dorëzon për kontroll doganierit.

6.Në varësi të vlerës së mallit bëhet selektimi se cilat dërgesa i nënshtrohen procedurës së doganimit.

7.Për dërgesat që vijnë nga Kina duhet kushtuar kujdes sa i përket vlerës dhe natyrës së mallit, pasi që tek këto dërgesa vlera e përshkruar në fletëdërgesë ka tendencë të jetë e pasaktë.

8.Secilës dërgesë që ndalet në Doganë i vendoset një numër identifikues, ku numri i parë është numri i manifestit dhe numrat e tjerë janë numrat sipas renditjes kronologjike të asaj dite (p.sh.numri i manifestit 3, kurse numri pasues mund të jetë 15, numri i dërgesës së ndalur do të jetë 3-15), por që numër bazë identifikues i dërgesës është numri "tracking" i dërgesës dhe ky numër e përcjellë dërgesën nga vendi dërgues.

9.Punonjësi i Postës duhet t'i peshojë të gjitha dërgesat e selektuara për tu ndalur në Doganë dhe në fletëdërgesë (që është e ngjitur në koli) ta shkruajë peshën e saktë.

10.Dërgesat e letrave që nuk i nënshtrohen kontrollit doganor d.m.th. të cilat, në momentin që futen në territorin doganor të Republikës së Kosovës konsiderohen të deklaruara për qarkullim të lirë dhe nga Posta Transite dërgohen në postat e destinimit për t'ua dorëzuar marrësve.

4.1.2. Dërgesat e koli postës

1.Të gjitha kolutë vendosen fillimisht në X-ray për skanim.

2.Kolutë duhet të hapen për të konstatuar përmbajtjen e kolisë dhe varësisht prej përmbajtjes së kolisë dhe vlerës, të ndahen kolutë që ndalen në Doganë për të iu nënshtuar procedurës së doganimit, kurse kolutë e tjera ndahen për tu dërguar direkt në zyrën postare përkatëse të pranuesit.

3.Për çdo thes me koli, Posta Transitore/sektori i Postës Doganore QTP përpilon fletëdërgesën postare doganore në katër kopje, të vërtetuar nga autoriteti doganor, ndërsa tri kopjet e mbetura i dërgohen zyrës postare doganore kompetente në emër të së cilës janë dërgesat postare, e cila pas zhdoganimit një kopje e ndalë për vete, një i dorëzon palës dhe një ia kthen Postës Transitore/sektorit të Postës Doganore QTP.

4.1.3.Trajtimi i dërgesave të dëmtuara

1.Në rast të arritjes së dërgesës dukshëm të dëmtuar ose me defekt, zyrtarët e QTP-së, në prani të zyrtarit doganor, përpilojnë procesverbalin për parregullsitë në formularin CN 24.

2.Procesverbali bëhet në pesë kopje, i nënshkruar dhe i vërtetuar nga punonjësi i Postës dhe zyrtari doganor.

3.Një kopje e procesverbalit mbahet në Zyren e Postës Doganore në QTP, një kopje ju dorëzohet Doganës së Kosovës, dy kopje i bashkëngjiten dhe dërgohen bashkë me dërgesën dhe një kopje (e përkthyer në anglisht ose frëngjisht) Posta Transitore do t'i dorëzojë Postës Transitore të shtetit të jashtëm, bashkë me njoftimin për parregullsitë CN43 ose CP78.

4.2. Dërgesat postare në import të cilat nuk i nënshtrohen ekzaminimit doganor

1.Në bazë të dispozitave të nenit 142, paragrafi 1, pika 1 (1) të UA 11/2009 për dispozitat zbatuese të KDA-së, dërgesat postare të mëposhtme do të konsiderohen të deklaruara pranë autoritetit doganor, për t'u vendosur në qarkullim të lirë në momentin e hyrjes në territorin doganor:

- dërgesat me letra, ekskluzivisht me mesazhe personale;
- secogramet;
- materialet e shtypura që nuk i nënshtrohen detyrimeve të importit;
- të gjitha dërgesat e tjera postare (dërgesa letrash dhe koli), të cilat në përputhje me dispozitat mbi trafikun kufitar dhe postar të udhëtarëve, nuk duhet të dorëzohen në Zyrën Doganore dhe
- Dërgesat postare të devijuara për një shtet të tretë.

2.Dispozitat e mësipërme nuk zbatohen për dërgesat e cekura në vijim, të parapara me s nenin 143 të UA 11/2009 për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor dhe të Akcizave, :

- Dërgesat që përmbajnë mallra për qëllime komerciale të vlerës së përgjithshme që tejkalon pragun statistikor të paraqitur sipas dispozitave të Republikës së Kosovës në fuqi, Dogana mund të përcaktojë prag më të lartë;
- Dërgesat që përmbajnë mallra për qëllime komerciale dhe që përmbajnë një seri të akteve të tilla;
- Kur deklarata doganore është bërë me shkrim, me gojë apo duke shfrytëzuar teknikën e përpunimit të të dhënave;
- Dërgesat që përmbajnë mallra të referuara në nenin 140 të këtij akti.

Neni 5.

PROCEDURA NË ZYRËN POSTARE DOGANORE

5.1. Zyrtarët e Postës së Kosovës në cilësinë e agjentit doganor

1.Zyrtarët e Postës së Kosovës në cilësinë e agjentit doganor do të plotësojnë dokumentacionin doganor siç janë: Deklarata Postare Doganore (DPD) dhe Dokumenti Unik Doganor (DUD), përmes së cilave mundësohet procedura e thjeshtësuar e zhdoganimit të dërgesave postare.

2.Gjatë punës së tyre, zyrtarët e Postës së Kosovës që plotësojnë T1, Manifestin, DPD dhe DUD, do të udhëhiqen nga parimi i transparencës, përgjegjësisë së lartë dhe llogaridhënies.

Puna e këtyre zyrtarëve do të mbikëqyret dhe monitorohet nga ana zyrtarëve doganorë, për të u siguruar që gjatë procesit të plotësimit të T1, Manifestit, DPD dhe DUD po respektohen rregullat e parapara me Kodin Doganor dhe të Akcizave.

3.Për një proces të unifikuar verifikimi, krijohet një manual me udhëzime të qarta për inspektimin dhe verifikimin doganor, duke përfshirë kontrollet e sigurisë, dokumentet dhe inspektimin fizik të mallrave.

5.2. Pranimi i thasëve me dërgesa postare

1. Dërgesat postare, të cilat në fazën paraprake të ekzaminimit të dërgesave janë ndalur për të iu nënshtruar procedurës doganore të doganimit, nga punonjësit e Postës dërgohen në hapësirën e Doganës, të destinuar për strehimin e dërgesave që janë në pritje të doganimit.
2. Lista me dërgesat e ndalura do të dërgohet nga punonjësit e Postës në Zyrën Postare të Zhdoganimit (Postën Doganore).
3. Nga punonjësit e Postës duhet të përgatitet një njoftim që do tu dërgohet pranuesve të dërgesave, përmes së cilit do të njoftohen që dërgesa është ndalur për të iu nënshtruar procedurës së doganimit.
4. Njoftimi do të përmbajë këto informata:
 - Që dërgesa është ndalur për doganim;
 - Që porositi/pranuesi duhet të dërgojë me e-mail dokumentet: urdhërporosinë (ordinin) "screen shot" apo "printscreen"; transferin e bankës (pagesën e bankës për produktin) dhe letërnjoftimin foto apo të skanuar në të dy anët;
 - Duhet të përshkruhet e-mail adresa ku duhet të dërgohen dokumentet;
 - Numrin e telefonit kontaktues zyrtar ku mund të kërkohen sqarime;
 - Njoftimin që pasi të pranohen këto dokumente, dërgesa do t'i dërgohet në postën e komunës së tyre dhe se pagesa e detyrimeve doganore kryhet në atë zyre postare;
 - Përshkrimin e dispozitës së Kodit Doganor dhe të Akcizave që përcakton që porositi online deri në 35.00 euro lirohen nga pagesa, kurse mbi këtë vlerë i nënshtrohen pagesës së taksave doganore;
 - Përshkrimin e dispozitës së Kodit Doganor dhe të Akcizave që përcakton që dërgesat e dërguara nga personi fizik jashtë Kosovës për personin fizik në Kosovë (kolitë familjare, dhuratat) deri në 50.00 euro lirohen nga pagesa, kurse mbi këtë vlerë i nënshtrohen pagesës së taksës doganore;
 - Njoftimin që afati për të përfunduar procedurën doganore për dërgesën është 30 ditë dhe nëse brenda këtij afati nuk përfundohet procedura, dërgesa kthehet tek dërguesi apo i nënshtrohet konfiskimit.
5. Njoftimi i palëve lidhur me dërgesat, të cilat janë ndaluar për pagesën e tarifave doganore do të bëhet përmes kontaktit me telefon, me thirrje dhe mesazhe përmes telefonit, duke kërkuar konfirmimin e marrjes së mesazhit ose përmes e-mailit.
6. Në rastet kur palët nuk mund të kontaktohen në këtë formë, atëherë në adresë të tyre dërgohet fletënjoftimi.
7. Formë tjetër e njoftimit të palëve është gjurmimi në SASP, ku palët mund të gjurmojnë dërgesën e tyre. Në SASP, për palët duhet të përshkruhet mesazhi i njëjtë sikur në fletënjoftimin që dërgohet në adresë të tyre.

5.3. Procesimi sipas procedurës së shkurtër të Deklaratës Postare Doganore (DPD) dhe Dokumentit Unik Doganor (DUD)

1. Blerjet online që personat fizik në Kosovë i bëjnë nga kompani shitëse të jashtme dhe në të cilat konsiderohet që janë pasqyruar vlerat reale të çmimit të blerjes, mund të procesohen me plotësimin e DPD-së pa kërkuar dokumente shtesë.
2. Që të mund të aplikohet një procedurë e tillë, në fletëdërgesë duhet të jetë përshkruar emri dhe mbiemri i pranuesit, si dhe adresa e saktë e tij.
3. Udhëheqësi në Postën Doganore, në konsultim me udhëheqësin e zyrës përkatëse doganore, të cilës i përket si strukturë vartëse Posta Doganore, në mënyrë periodike do të bëjnë analizën e blerjeve online për të cilat përshkrimi i vlerës në fletëdërgesë – CN22 dhe CN23, që i ngjitet kolisë, ka rezultuar si vlerë reale nga dokumentet e prezantuara nga palët. Për këtë do të hartohet një listë e këtyre kompanive shitëse të jashtme, të cilat përshkruajnë saktë vlerën e mallit që do tu shërbejë zyrtarëve të autorizuar si referencë se cilat dërgesa do të mund të procesohen sipas procedurës së shkurtuar doganore.
4. DPD për këtë kategori të blerjeve online duhet të procesohet brenda afatit prej 4 ditëve, prej ditës kur dërgesa është vendosur në hapësirën e Postës Doganore për strehimin e dërgesave të ndalura për doganim.

5.4. Përgjegjësia në rastin e dorëzimit të dërgesave postare te pranuesi

1. Me rastin e plotësimit të të dhënave të pranuesit duhet të shënohet: emri, mbiemri, adresa/qyteti, kurse tek numri personal duhet të vendosen 1111111111 dhe pasi të përfundohet DPD dhe pasi të dhënat të futen në SASP, dërgesa postare me listën shoqëruese duhet të dërgohet në zyrën postare që gjendet në vendbanimin apo komunën e pranuesit.
2. Përgjegjësia gjatë dorëzimit të dërgesës te pranuesi bie mbi zyrtarin përgjegjës të zyrës këmbëse postare, i cili është i obliguar që të iu përmbahet rregullave të dorëzimit, të parapara me Ligjin për Shërbimet Postare, rregulloreve dhe akteve të brendshme të ndërmarrjes. Para se të pranojë dërgesën postare, pranuesi duhet të kryejë pagesën e tarifës për zhdoganim dhe pagesën e tarifës për përpunim të dërgesës postare. Pasi të kryhen të gjitha detyrimet, dërgesa postare mund të tërhiqet nga pranuesi.
3. Gjatë dorëzimit, zyrtari përgjegjës i zyrës këmbëse duhet t'i përmbahet rregullave për dorëzimin e dërgesës postare te pranuesi, që do të thotë se dërgesa postare duhet t'i dorëzohet pranuesit e hapur në prezencë të tij dhe t'i shpjegohen procedurat të cilat do të ndiqen nëse marrësi e refuzon pranimin e dërgesës.
4. E njëjta procedurë duhet të ndiqet edhe për dërgesat e personave fizik jashtë Kosovës të destinuar për personat fizik në Kosovë (dhuratat, pakot familjare, etj), nëse konsiderohet se përshkrimi i vlerës në fletëdërgesë pasqyron vlerën reale të mallit/produkteve që gjenden brenda kolisë. Kjo procedurë do të jetë e mundur nëse në fletëdërgesë është i përshkruar: emri dhe mbiemri, adresa, po ashtu edhe për këtë kategori tek numri personal mund të shkruhet 1111111111.

5.5. Caktimi i tarifës për procedurën e Deklaratës Postare Doganore (DPD) dhe Dokumentit Unik Doganor (DUD)

Për kryerjen e procedurave të parapara me këtë Rregullore, plotësimi i Deklaratës Postare Doganore dhe plotësimi i Dokumentit Unik Doganor, Posta e Kosovës Sh.A. do të caktojë një tarifë, me të cilën do të ngarkojë pranuesit e dërgesave postare të zhdoganuara.

5.6. Deklarata postare doganore (DPD)

5.6.1. Deklarata postare doganore për persona fizik

1. Pas pranimit të dokumenteve të nevojshme nga palët/pranuesit e dërgesave, punonjësit e Postës në cilësinë e agjentëve doganor duhet të:

- Verifikojnë që dokumentet e dërguara nga palët janë në rregull;
- Nëse dokumentet nuk janë të kompletuara, punonjësit e Postës do ta njoftojnë përmes e-mailit palën se cilat dokumente shtesë duhet t'i dërgojë;
- Printojnë dokumentet e dërguara nga palët me e-mail;
- Gjejnë dërgesën/kolinë, ta hapin dhe të krahasojnë nëse produkti në koli është i njëjtë me produktin e përshkruar në urdhërporosi.
- Në sistemin ASYCUDA përpilohet DPD.

Në DPD duhet të plotësohen të gjitha fushat obligative të kërkuara nga sistemi:

- ❖ Të dhënat e marrësit (*emri dhe mbiemri, adresa, numri personal*);
- ❖ Shteti dërgues apo i origjinës prej nga ka ardhur dërgesa;
- ❖ Duhet të përshkruhet nëse kemi të bëjmë me dërgesë letër postë apo dërgesë koli;
- ❖ Numri identifikues i dërgesës (*numri "tracking", si dhe numri identifikues në Doganë*);
- ❖ Pësia e dërgesës;
- ❖ Përshkrimi i mallit - emri tregtar i mallit;
- ❖ Sasia e mallit (përshkruhet në copë/pce, set dhe palë);
- ❖ Numri tarifor i mallit;
- ❖ Përshkrimi i procedurës (*procedura e zakonshme është 4000 / U40*);
- ❖ Vlera e mallit / baza doganore;
- ❖ Lloji i monedhës (euro, usd, chf apo ndonjë monedhë tjetër);
- ❖ Në Dok Scan në ASYCUDA duhet të bashkëngjiten të gjitha dokumentet që kanë të bëjnë me dërgesën/mallin (*kopja e fletëdërgesës, urdhërporosia/fatura, transferi i bankës/pagesa, letërnjoftimi kopje dhe dokumente të tjera nëse shoqërojnë dërgesën*);
- ❖ Pas këtij veprimi punonjësi i Postës do të bëjë validimin e DPD-së;
- ❖ Nga punonjësi i Postës do të gjenerohet urdhërpagesa për DPD;
- ❖ DPD dhe urdhërpagesa shtypen/printohen dhe bashkë me dërgesën procedohen tek Posta Transite për tu dërguar në zyrën postare të komunës së marrësit;
- ❖ Duhet të shtypen tri kopje DPD dhe tri kopje të urdhërpagesës.

2. Procedura që aplikohet pasi që dërgesa e shoqëruar me DPD dhe urdhërpagesë dërgohet në zyrën përkatëse postare:

- Zyra postare që pranon dërgesën, njofton palën për arritjen e dërgesës;
- Pasi të paguhen taksat doganore nga marrësi, zyra postare ia dorëzon dërgesën marrësit;
- Një kopje e DPD-së dhe një urdhërpagesë duhet t'i dorëzohen marrësit;
- Një kopje e DPD-së dhe e urdhërpagesës do të ruhen nga zyra postare që ia dorëzon kolinë marrësit;
- Një kopje e DPD-së me dokumentet e tjera do të ruhet nga punonjësit e QTP-së që kanë proceduar DPD-në.

3.Procedura e doganimit të dërgesave postare do të mund të kryhet edhe në Zyrën Postare Doganore, për palët të cilët paraqiten fizikisht në këtë zyrë. Procedura për doganimin e dërgesave për palët që paraqiten fizikisht është e njëjtë, përveç që palët pasi të kryejnë pagesën e detyrimeve doganore, do të mund të tërheqin dërgesën vet në këtë zyrë.

5.6.2. Dërgesat e ndalura në Doganë që rezultojnë nën pragun për doganim

1.Gjatë procesit të ekzaminimit dhe selektimit të dërgesave që ndalen në Doganë për të kryer procedurën e doganimit, meqenëse mallrat me origjinë prej vendeve aziatike nuk e kanë të deklaruar saktë vlerën e mallit në fletëdërgesë, ndonjë nga këto dërgesa pas verifikimit të vlerës mund të rezultojë nën pragun që i nënshtrohet procedurës së doganimit dhe pagesës së taksave doganore.

2.Dërgesat që rezultojnë nën vlerën **35.00** euro për porositë online dhe **50.00** euro për dërgesat e personit fizik nga jashtë për personin fizik në Kosovë, duhet të lirohen nga pagesa e taksave doganore konform dispozitave të nenit 27 – 30 të Aneksit A të Kodit Doganor dhe të Akcizave.

3.Këto dërgesa do të trajtohen nga zyrtari doganor dhe lirimi nga pagesa mund të bëhet vetëm prej zyrtarit doganor. Dërgesa e liruar duhet të protokollohet dhe me të gjitha dokumentet e skanuara duhet të vendoset në sistemin LESS dhe të bëhet shkarkimi manual në manifest (ASYCUDA) sipas numrit identifikues të dërgesës.

4.Dokumentet në kopje fizike që kanë të bëjnë me lirimet nga zyrtari doganor duhet të ruhen në një follder të veçantë dhe të arkivohen.

5.6.3. Baza doganore për kalkulimin e taksave doganore në DPD për personat fizik

1.Kalkulimi i detyrimeve të importit bëhet përmes Deklaratës Postare Doganore (DPD-së). Përmes këtij dokumenti bëhet edhe komunikimi i taksave doganore për palën/pranuesin e dërgesës.

2.Për qëllime të taksave doganore, si bazë doganore për përcaktimin e taksave doganore për blerjet online do të jetë:

- Vlera e mallit;
- Shpenzimet e transportit (shippingut);
- Shpenzimet të tjera nëse i ngarkohen blerësit dhe janë pjesë e çmimit të paguar.

3.Rrjedhimisht, si bazë doganore për kalkulimin e taksave doganore do të jenë komponentët e vlerës të përcaktuara me nenin 36 të Kodit Doganor dhe të Akcizave.

4. Për qëllime të taksave doganore, si bazë doganore për kalkulimin e taksave doganore për dërgesat e personit fizik jashtë Kosovës për personin fizik në Kosovë (dërgesat familjare) do të jetë:

- Vlera e mallit e përshkruar nga dërguesi;
- Kësaj vlere do t'i shtohen shpenzimet e transportit (shippingut).

5. Kalkulimi i taksave doganore bëhet në mënyrë automatike nga ASYCUDA, bazuar në numrin tarifor të mallit që përfshin taksat e plota (10% taksë doganore plus 18% TVSH).

5.6.4. Ankesa

1. Marrësi mund të kundërshtojë konstatimet e Zyrës Doganore në lidhje me llojin, cilësinë, sasinë dhe vlerën e mallit.

2. Nëse marrësi i dërgesës postare deklaron se paraqet ankesë, Posta do t'ia kthejë dërgesën e pahapur zyrës postare të zhdoganimit së bashku me DPD, fletën e dërgesës dhe ankesën e marrësit.

3. Procedura për paraqitjen e ankesës dhe marrjen e vendimit për të, rregullohet me dispozitat e nenit 291 të Kodit Doganor.

4. Zyra Postare Doganore do ta mbajë dërgesën derisa vendimi të jetë i plotfuqishëm, përkatësisht ekzekutueshmërisë së vendimit të organit doganor për ankesën, përveç nëse me akte të tjera përcaktohet ndryshe.

5.6.5. Trajtimi i dërgesave (letrat dhe koltë) të cilat i pranojnë personat juridikë

1. Kur një dërgesë postare pranohet nga jashtë nga një person juridik në Republikën e Kosovës, bashkë me deklaratat doganore CN22, CN23 dhe CP72, në përputhje me nenin 66 të KDA, paraqitet DUD-i për procedurën e kërkuar doganore.

2. Për dërgesat e natyrës komerciale do të procedohet Dokumenti Unik Doganor (DUD) dhe do të paraqitet në zyrën përkatëse doganore. Zhdoganimi përfundon në procedurë të rregullt doganore.

3. DUD-i dorëzohet edhe për dërgesat që lirohen nga detyrimet e importit, nëse parashikohet që për atë mall vërejtja për lirim vendoset në DUD.

4. Dërgesat, të cilat e përfundojnë procedurën e rregullt me DUD, duhet t'i dorëzohen pranuesit, pasi që në Zyrën Postare Doganore të dorëzohet DUD-i me dokumente përcjellëse, ku po ashtu duhet të jetë e bashkëngjitur edhe fletëdalja.

5. Përjashtimisht, Zyra Doganore mund të autorizojë zhvillimin e procedurës duke paraqitur një deklaratë nga deklaruesi p.sh. për materialin reklamues dhe mostrat që plotësojnë kushtet e parashikuara nga dispozitat e KDA-së për llojin, sasinë dhe vlerën e mallrave, për të cilat nuk paguhen detyrimet e importit.

6. Deklarata dorëzohet në dy kopje, njërën prej të cilave e mban Zyra Doganore dhe tjetrën paraqitësi.

5.6.6. Trajtimi i dërgesave për personat fizik, për të cilat janë përcaktuar kushte të veçanta

1.Nëse gjatë ekzaminimit doganor konstatohet se dërgesa postare për personin fizik përmban mallra për lëshimin e të cilave janë paraparë kushte të veçanta (p.sh. licencat, certifikata veterinare ose sanitare, kontroll i cilësisë, etj.) ose konstatohet se për lirimin e malli duhet të plotësohen kushte të tjera (p.sh. kushtet për zbatimin e disa prej lehtësirave doganore), punonjësi i Postës, para se të fillojë plotësimin e DPD-së, do të kryejë procedurën e kërkuar doganore dhe do t'ia lëshojë mallrat deklaruesit vetëm nëse plotësohen të gjitha kushtet e përcaktuara.

2.Në këto raste punonjësi i Postës do të mund të kërkojë mendimin profesional të zyrtarit doganor në Zyrën Postare Doganore.

3.Dërgesa do të mbahet në Postën Doganore deri në plotësimin e kushteve për përfundimin e procedurës së kërkuar, me ç'rast zyrtari doganor në deklaratën doganore postare dhe në mbështjellësin e dërgesës do të vendosë shënimin për arsyet e ndalimit.

4.Nëse marrësi i dërgesës nuk arrin të plotësojë kushtet për importimin e mallrave në fjalë, dërgesa do të kthehet jashtë vendit.

5.6.7. Trajtimi i mallrave importimi i të cilave është i ndaluar

1.Nëse gjatë ekzaminimit të mallit, konstatohet se dërgesa përmban mallra, importi i të cilave është i ndaluar, Zyra Doganore do të nxjerrë një vendim, i cili në përputhje me Kodin Doganor dhe të Akcizave, urdhëron postën e zhdoganimit që mallin ta kthejë jashtë vendit, në afat jo më të gjatë se tetë ditë nga marrja e vendimit, duke theksuar se malli do të konfiskohet nëse nuk kthehet jashtë vendit brenda afatit të caktuar.

2.Posta e Zhdoganimit e kthen këtë dërgesë jashtë vendit nëpërmjet Postës Transit, duke përpiluar fletëdërgesën postare doganore, në bazë të së cilës dërgesa shkarkohet në manifest (ASYCUDA).

3.Nëse gjatë kontrollit të përmbajtjes konstatohet se dërgesa përmban narkotikë, substanca psikotrope, lëndë radioaktive, eksplozivë të ndezshëm ose sende të tjera të rrezikshme, për të cilat nuk plotësohen kushtet për import, Posta e Zhdoganimit do ta përjashtojë këtë ngarkesë nga procedura dhe do t'ia dorëzojë Zyrës Doganore për veprim të mëtejshëm.

4.Për këtë përpilohet procesverbali mbi konfiskimin e dërgesës postare, i cili nënshkruhet nga zyrtari i Postës dhe zyrtari doganor.

5.6.8. Trajtimi i mallrave të fshehura

1.Nëse gjatë kontrollit doganor konstatohet se dërgesa përmban mallra të fshehura, gjegjësisht se malli ose një pjesë e mallit janë të paketuara në atë mënyrë që tregon qartë qëllimin për të shmangur pagesën e borxhit doganor, punonjësi i Postës në Zyrën Postare të Zhdoganimit do ta njoftojë zyrtarin doganor, prej nga do të përpilohet një procesverbal në tri kopje, i nënshkruar nga zyrtari doganor dhe punonjësi i Postës në Zyrën Postare të Zhdoganimit.

2.Dy kopje të procesverbalit, së bashku me mallin e fshehur, të cilit i referohet procesverbali, i mbeten organit doganor kompetent për veprime të mëtejshme, ndërsa kopja e tretë mbahet në Postën e Zhdoganimit dhe vendoset shënim në deklaratën postare doganore.

3.Pjesën e mbetur të dërgesës Posta e Zhdoganimit do ta paketojë dhe do ta vazhdojë procedurën e zhdoganimit.

4.Trajtimi i mëtejshëm i mallrave të fshehura për të cilat është bërë një procesverbal, varet nga vendimi që do të nxirret lidhur me kualifikimin e kundërvajtjes, si dhe statusin e mallit të fshehur.

5.6.9. Dorëzimi i dërgesës organit tjetër kompetent

Në rast se një autoritet kompetent (organ i punëve të brendshme, gjykata, inspektorati apo ndonjë autoritet tjetër kompetent) paraqet kërkesë për dorëzimin e një dërgese të pa zhdoganuar, Posta e Zhdoganimit, për të kryer procedurën e duhur përpilon procesverbalin CN13-Njoftim për konfiskimin e dërgesës, të cilin e nënshkruajnë zyrtari doganor, punonjësi i Postës së Zhdoganimit dhe një punonjës i një autoriteti tjetër kompetent që parashtron kërkesën.

5.6.10. Afatet për kryerjen e procedurës doganore

1.Procedura doganore për dërgesat postare duhet të përfundojë jo më vonë se katër ditë nga dita e paraqitjes së tyre në Zyrën Doganore, në rastet kur kemi të bëjmë me dërgesa të cilat nuk kanë nevojë për dokumentacion shtesë dhe të cilat mund të procesohen pa ndonjë pengesë në zyrën postare të adresës së pranuesit.

2.Përjashtimisht për arsye të justifikueshme, ky afat mund të jetë më i gjatë në rastet kur Zyra Postare e Zhdoganimit është në pritje të dokumentacionit nga pranuesi për të bërë të mundur procesimin e DDP-së.

3.Afati maksimal që dërgesa duhet të qëndrojë në Zyrën Postare të dorëzimit/zhdoganimit do të jetë 30 ditë. Nëse brenda këtij afati dërgesa nuk arrin të procedohet në DPD apo procedurë tjetër doganore, nga punonjësi i Postës duhet t'i kthehet dërguesit.

Nëse dërgesa nuk pranohet nga dërguesi dhe kthehet prapa në QTP/Zyrën e Zhdoganimit Postar, e njëjta do t'i nënshtrohet procedurës së konfiskimit dhe kjo procedurë do të kryhet nga zyrtari doganor.

5.Procedura doganore me dërgesat EMS dhe dërgesat urgjente, dërgesat që përmbajnë kafshë të gjalla, mallra që prishen lehtë dhe medikamente, duhet të përfundojë brenda një afati optimal dhe sa më të shpejtë nga momenti i dorëzimit të dërgesave në fjalë në Zyrën Doganore, ndërsa për dërgesat me përparësi/dërgesat me avion duhet të përfundojë brenda një afati optimal dhe të arsyeshëm nga paraqitja e tyre në organin doganor, përveç nëse ekzistojnë arsye ose pengesa të tjera të justifikuara për të cilat procedura nuk mund të kryhet brenda atij afati.

5.6.11. Mbyllja e dërgesave

P1.as ekzaminimit doganor të dërgesës postare, punëtori i postës kompetente të zhdoganimit e kthen përmbajtjen e dërgesës në mbështjellës (zarf apo paketë) dhe e paketon në atë mënyrë që të mos dëmtohet përmbajtja e dërgesës, dhe që te pranuesi të arrijë pa dëmtime dhe në përputhje me dispozitat e përgjithshme dhe të veçanta për paketimin dhe mbylljen e dërgesave në trafikun ndërkombëtar.

2.Pas mbylljes së dërgesës postare, posta kompetente e zhdoganimit në mbështjellës vendos shenjën “Doganuar”, përkatësisht etiketën “I liruuar nga detyrimet doganore”, varësisht nga rasti konkret.

5.6.12. Trajtimi i dërgesave të pa dorëzuara

1.Në rastin kur dërgesa postare nuk mund t’i dorëzohet pranuesit, si dhe në rastin kur pranuesi refuzon të pranojë dërgesën dhe nuk bëhet fjalë për mospajtim me konstatimet e organit doganor, dërgesa, si e padorëzuar, bashkë me dokumentet përcjellëse, do t’i kthehet zyrës postare kompetente të zhdoganimit.

2.Zyra kompetente postare e zhdoganimit dërgesën e pa dorëzuar të kthyer nga posta e destinacionit, pasi e matë ia dorëzon me listë doganës në të cilën është zhdoganuar për rishikim. Nëse organi doganor në rishikim konstaton se përmbajtja e dërgesës është e pandryshuar, dërgesa do t’i kthehet dërguesit jashtë vendit menjëherë dhe më së voni brenda 48 orëve.

3.Punonjësi i Postës së Zhdoganimit përpilon procesin e kthimit që do të nënshkruhet nga punonjësi i Postës së Zhdoganimit dhe zyrtari doganor dhe dërgesën bashkë me procesin e kthimit e proceson tek QTP për kthim. Kjo dërgesë duhet të peshohet prapë para se të procedohet për kthim.

4.Nëse dërgesa nuk pranohet nga dërguesi, dërgesa e tillë ndalet prapë në Postën e Zhdoganimit, edhe njëherë njoftohet pranuesi që dërgesa nuk është pranuar nga dërguesi dhe pyetet nëse ka interes për të kryer procedurën e doganimit.

5.Nëse pranuesi prapë refuzon të kryejë procedurën e doganimit, atëherë brenda afatit prej 30 ditëve, dërgesa do t’i nënshtrohet procedurës së konfiskimit.

6.Procedura e konfiskimit të dërgesës do të kryhet nga zyrtari doganor, konform procedurës së përcaktuar për konfiskimin e dërgesave të patrajtuara.

7.Zyra Doganore do të shkarkojë deklaratën postare doganore me numrin e fletëdërgesës postare doganore në manifest ku përshkruhet “dërgesa është kthyer tek dërguesi”.

8.Pranuesit të dërgesës do t’i dërgohet një kopje e procesit mbi kthimin e dërgesës.

9.Nëse për dërgesën e tillë është përgatitur DPD, nga zyrtari doganor do të bëhet anulimi i DPD-së me vërejtjen “dërgesa nuk është pranuar nga marrësi dhe është kthyer prapa”.

10.Dërgesa për të cilën është përpiluar DPD, por nuk i është dorëzuar pranuesit apo është refuzuar nga pranuesi, do të kthehet në Postën e Zhdoganimit. Posta e Zhdoganimit përpilon një njoftim për parregullsitë për postën e destinacionit. Zyra Postare e Zhdoganimit i paraqet organit doganor një deklaratë, në të cilën i cekë të gjitha të dhënat përkatëse të nevojshme për shkarkimin e dërgesës së pa zhdoganuar në deklaratën doganore postare dhe për veprim në lidhje me borxhin doganor të llogaritur. Në këtë rast, Zyra Doganore e bën shkarkimin në bazë të të dhënave dhe dëshmimeve të tij se dërgesa është kthyer jashtë vendit.

11.Nëse gjatë kontrollit doganor konstatohet se përmbajtja e dërgesës është plotësisht e papërdorshme, përpilohet procesverbali CP7 dhe procesverbali mbi asgjësimin në katër kopje. Procesverbalin për asgjësim e nënshkruajnë punëtori i Postës dhe doganieri.

12.Në deklaratën postare doganore, në kolonën “vërejtje”, vendoset shënimi përkatës për një dërgesë specifike.

13.Nëse konstatohet se përmbajtja e dërgesës është pjesërisht e papërdorshme, Posta e Zhdoganimit përpilon procesverbalin CP7 në katër kopje, të nënshkruar nga punonjësi i Postës dhe doganieri.

14.Pjesa e mbetur, e përdorshme, e përmbajtjes së dërgesës, i dërgohet marrësit me dy kopje të procesverbalit në fjalë. Në kolonën “vërejtje” të deklarates doganore postare vendoset shënimi përkatës për dërgesën në fjalë.

15.Dërgesa postare e pa dorëzuar që duhet të kthehet jashtë vendit dhe për të cilën dërguesi ka shënuar se në rast të mosdorëzimit heq dorë nga dërgesa, i dorëzohet Zyrës Doganore për veprime të mëtejshme, me dokumentacion shoqërues.

16.Në të njëjtën mënyrë trajtohet dërgesa e pa dorëzuar që nuk mund të kthehet jashtë vendit, sepse nuk mund të verifikohet vendi i origjinës. Përveç dërgesave të cekura, Posta e Zhdoganimit duhet t’i dorëzojë autoritetit doganor një deklaratë me shkrim për arsyet e dorëzimit të dërgesës.

5.6.13. Përfundimi i procedurës

Pas kryerjes së ekzaminimit doganor përfundon procedura me dërgesat në Zyrën Doganore, kurse Posta e Zhdoganimit i dërgon dërgesat e zhdoganuara së bashku me dokumentacionin shoqërues në postat e destinacionit.

Neni 6.

PROCEDURA DOGANORE PËR DËRGESAT POSTARE TË CILAT DËRGOHEN JASHTË VENDIT

6.1. Procedura në Postën e Zhdoganimit

1.Dërgesat postare të destinuara për eksport, pra që dërgohen jashtë vendit dhe për të cilat ekziston detyrimi për t’ia dorëzuar Zyrës Doganore, mund t’i dorëzohen çdo njësie organizative të rrjetit postar (në tekstin e mëtejme posta e pranimit) ose drejtpërdrejt në zyrën postare në objektin e QTP-së. Dërgesat postare që i nënshtrohen kontrollit doganor pranohen në zyrën postare të hapura dhe mund të merren vetëm si të regjistruara.

2.Pas pranimit, punonjësi postar kontrollon nëse dërgesat janë përgatitur në përputhje me dispozitat që rregullojnë pranimin e dërgesave jashtë vendit, si dhe nëse ato i plotësojnë kushtet për import në shtete të caktuara të destinacionit. Nëse këto kushte nuk plotësohen në përputhje me dispozitat postare, dërgesa i kthehet dërguesit.

3.Posta e pranimit, për të kryer procedurën doganore, dërgesat e marra i dërgon në zyrën postare kompetente të zhdoganimit, me ç’rast në dërgesë vendos shenjën “i nënshtrohet kontrollit doganor”.

4.Dërgesat postare të dorëzuara nga personat juridik me DUD, për kryerjen e procedurës doganore, pranohen ekskluzivisht në zyrat postare të zhdoganimit.

5.Dërgesat postare me mallra që janë zhdoganuar përmes eksportit, mund të dorëzohen në çdo zyrë postare me DUD për t’i dërguar jashtë vendit.

6. Dërgesat të cilave u mungon një dokument i caktuar nuk dorëzohen në organin doganor. Nëse konstatohet se një dërgesë e tillë ka mbërritur në zyrën doganore, ajo do t'i kthehet postës pranuese brenda tri ditëve nga dita e marrjes.

6.1.1. Dërgesat të cilat nuk i nënshtrohen ekzaminimit doganor në eksport

1. Dërgesat postare konsiderohet se janë deklaruar në Zyrën Doganore për eksport në momentin kur pranohen nga operatorët postarë, në rastin e dërgesave me letra dhe paketë. Këto mund të jenë:

- dërgesat me letra, ekskluzivisht me mesazhe personale - Braille (sekogram),
- materiale të shtypura që nuk i nënshtrohen pagesës së detyrimeve, dhe
- të gjitha dërgesat e tjera postare (dërgesa letrash dhe koli) për të cilat, në përputhje me dispozitat për trafikun e udhëtarëve, dhe trafikun postar, nuk ekziston detyrimi për dorëzimin në Zyrën Doganore.

2. Këto dërgesa nuk dërgohen nga posta pranuese në postën doganore për ekzaminim doganor në Zyrën Doganore, por dërgohen nga posta pranuese në postën kompetente transite dhe konsiderohen se janë paraqitur në Zyrën Doganore, kurse deklarata doganore është pranuar dhe futja në procedurën e eksportit është lejuar në momentin kur dërgesat janë pranuar në postën e pranimit.

3. Nëse zyrtari doganor në zyrën postare konsideron se një ngarkesë e caktuar duhet të dorëzohet për kontroll doganor, ai mund ta ndajë ngarkesën specifike dhe ta dërgojë atë në Zyrën Postare Doganore, ku punonjësi i Postës vendos shenjën "i nënshtrohet doganës inspektimit".

4. Doganieri në Postën Transite, nëse konsideron se një ngarkesë e caktuar duhet të paraqitet për kontroll doganor, ai mund ta ndajë dërgesën konkrete dhe ta dërgojë atë në Zyrën Postare të Zhdoganimit, ku punonjësi i Postës në Postën Transite vendos shenjën "i nënshtrohet ekzaminimit doganor".

6.1.2. Paraqitja e dërgesave postare në Zyrën Doganore

Dërgesat postare që i nënshtrohen kontrollit doganor dhe që plotësojnë kushtet për dërgim jashtë vendit, të dorëzuara në postën e pranimit apo në Postën e Zhdoganimit, punonjësi i Postës së Zhdoganimit ia paraqet për kontroll doganor zyrtarit doganor.

6.1.3. Deklaratat doganore postare CN22 dhe CN23

1. Për dërgesat postare që i nënshtrohen kontrollit doganor, kur i dorëzohen postës pranuese ose Postës së Zhdoganimit, dërguesi (person juridik ose fizik) duhet t'i plotësojë deklaratat doganore CN22 (për letra dhe EMS) dhe/ose CN23, për të cilat ai konfirmon saktësinë e të dhënave duke i nënshkruar në rubrikën përkatëse. Për eksportin e mallrave në dërgesa postare, dërguesi (sipërmarrës ose person juridik) plotëson deklaratën CP72.

2.Konsiderohet se dërgesat postare deklarohen për eksport në momentin e paraqitjes në zyrën doganore të deklaratës doganore postare CN22, CN23 dhe CP72.

Për eksportin e dërgesave postare që përmbajnë mallra të rëndësishme të vogël ekonomike, në vlerë të përgjithshme deri në 1,000. 00 euro, për sipërmarrësit dhe shoqëritë tregtare (POST EXPORT) ndiqet procedura e deklarimit me gojë.

6.1.4. Dokumenti Unik Doganor (DUD)

1.Për mallrat për të cilat kërkohet kthimi i detyrimeve të importit ose për mallrat që u nënshtrohen kufizimeve, ndalimeve ose formaliteteve të tjera të veçanta, për dërgesat që përmbajnë mallra të natyrës komerciale, vlera totale e të cilave kalon 35.00 euro, për dërgesat që përmbajnë mallra të natyrës komerciale, si pjesë e disa veprimeve të ngjashme, për mallrat për të cilat është paraqitur një deklaratë me shkrim, me gojë ose me shkëmbim elektronik të të dhënave, e cila dërgohet jashtë vendit në dërgesa postare, Doganës i paraqitet dokumenti unik doganor (DUD).

2.Dokumentin unik doganor (DUD) e paraqet eksportuesi i mallrave (deklaruesi) ose përfaqësuesi i tij i autorizuar, i cili i plotëson kushtet për kryerjen e veprimtarive të përfaqësimit në procedurën doganore. DUD-i për vendosjen e mallrave në procedurën e eksportit plotësohet në mënyrën e përcaktuar me dispozitat e KDA-së për formën, përmbajtjen, mënyrën e paraqitjes dhe plotësimin të deklaratave dhe formularëve të tjerë në procedurën doganore.

3.Dokumentin unik doganor, DUD-i, duhet të jetë i nënshkruar, duhet t'i përmbajë të gjitha të dhënat dhe duhet të shoqërohet me të gjitha dokumentet e nevojshme për zbatimin e dispozitave në lidhje me procedurën e kërkuar. Procedura sipas deklaratës zhvillohet (kontrolli i deklaratës, procesverbali për ndryshimin e të dhënave, etj.) dhe përfundon sipas dispozitave të Kodit Doganor.

6.1.5. Deklarata

Nëse dërgesat e destinuara për eksport përmbajnë mostra të disa mallrave, materiale reklamuese, artikuj të ekspozuesve vendas në panairt e huaja, libra, etj., procedura me të njëjtat mund të kryhet me paraqitjen e deklaratës. Deklarata paraqitet në dy kopje, njërin prej të cilave e mban Zyra Doganore dhe tjetrën deklaruesi.

6.1.6 Trajtimi i deklaratave të pasakta

1.Kur Zyra Doganore konstaton disa mangësi ose pasaktësi në deklaratat e paraqitura CN22, CN23, CP72 apo DUD, të njëjtat do t'i kthejë në Zyrën Postare të Zhdoganimit, duke treguar pse janë të pasakta. Posta e Zhdoganimit është e detyruar t'i eliminojë mangësitë dhe pasaktësitë, vet apo me paraqitësin e deklaratës në postën e pranimit dhe Zyrës Doganore ia paraqet deklaratën e saktë. Nëse deklaruesi nuk pajtohet me vërejtjet e Doganës, Zyra Doganore do të veprojë në atë mënyrë e cila rregullon çështjen e pranimit të një deklarate, e cila nuk i plotëson kushtet për atë fazë të procedurës doganore.

2.Nëse procedura e zhdoganimit në eksport kryhet në Zyrën Doganore përmes një përfaqësuesi të autorizuar, deklaruesit të DUD-it, trajtimi i DUD-it të pasaktë bëhet në përputhje me dispozitat e Kodit Doganor.

6.1.7. Ekzaminimi doganor i dërgesave në eksport

1. Dërgesat, të cilat i plotësojnë kushtet për dërgim jashtë vendit, Posta Doganore i dorëzon për kontroll në Zyrën Doganore në të njëjtën ditë, duke pasur parasysh përparësinë e dorëzimit të dërgesave. Gjatë zhdoganimit në eksport përparësi kanë letrat dhe letrat me rëndësi të theksuar në raport me paketat. Përparësi në zhdoganim kanë dërgesat EMS, si dhe dërgesat që përmbajnë mallra që prishen lehtë dhe barnat.
2. Punonjësi i Postës Doganore hap dërgesën postare, të cilën e paraqet për ekzaminim dhe përmbajtjen e saj ia paraqet doganierit të autorizuar. Pas kontrollit doganor, nëpunësi postar mbyll dërgesën, heq shenjën "I nënshtrohet kontrollit doganor" dhe vendos shenjën "Zhdoganuar".
3. Nëpunësi i autorizuar doganor vendos nënshkrimin e tij në fletëngarkesë dhe e vulos. Nëse është e nevojshme, i verifikon edhe faturat shoqëruese.
4. Nëse gjatë kontrollit të dërgesës konstatohet se dërgesa përmban mallra, eksporti i të cilave është i ndaluar, Posta e Zhdoganimit, sipas urdhrat të Zyrës Doganore, e kthen dërgesën në postën e pranimit me njoftimin për pasaktësitë (P-61), me vërejtjen "Ndalohe për eksport".
5. Nëse dërgesa përmban mallra që i transferohen autoritetit kompetent, do të përpilohet procesverbali për pasaktësitë e dërgesës (P-63). Pjesën e mbetur të dërgesës Posta Doganore ia kthen postës së pranimit bashkë me njoftimin për pasaktësitë (P-61), me arsyet e deklaruara të kthimit.

6.1.8. Dërgimi i dërgesave nga zyra postare e pranimit në Qendrën Transitore

1. Dërgesat postare të zhdoganuara për eksport, zyra postare i dërgon në Qendrën Transite, duke përpiluar një fletëdërgesë doganore postare në katër kopje, të vërtetuara nga Zyra Postare Doganore. Kopjen e parë e mban Zyra Postare Doganore, ndërsa tri të tjerat i dorëzohen Postës së Zhdoganimit. Posta e Zhdoganimit ruan një kopje për vete, kurse dy kopje ia bashkëngjet bashkë me listën e këmbimit të thasëve dhe e dërgon në Qendrën Transite.
2. Për zhdoganimin e dërgesës, të cilën në eksport e shoqëron DUD-i, në vërejtjen e fletëdërgesës shënohet numri i deklaratës. Bashkë me fletëdërgesën e dërgesës doganore bashkëngjiten dy kopje të DUD-it, për secilën dërgesë të zhdoganuar në këtë mënyrë.

6.2. Procedura në Qendrën Transite

1. Pas arritjes së thasëve në Qendrën Transite, Zyra Doganore pranë Qendrës Transite vërteton të dy kopjet e fletëdërgesës doganore postare, e regjistron në librin e dërgesave postare në eksport. Njërin kopje e ruan, kurse tjetrën ia kthen Zyrës Doganore. Sipas dinamikës së përcaktuar më parë, autoriteti doganor në Postën Transitore ia konfirmon Postës së Zhdoganimit pranimin e fletëdërgesës doganore postare.

2. Oficerit të autorizuar doganor, i cili vërteton fletëdërgesën doganore postare, i dorëzohen të dyja kopjet e DUD-it. Zyrtari doganor, duke vërtetuar fletëdërgesën doganore postare, konfirmon se ka marrë në dorëzim dokumentacionin shoqërues (DUD) për dërgesën në fjalë.

3. Nëse ndodh që një dërgesë postare të mbërrijë në Postën Transitore, në ambalazhin e së cilës nuk ka të dhëna se është kryer kontrolli doganor (p.sh. nuk ka shenjën "E zhdoganuar") dhe bëhet fjalë për dërgesën që i nënshtrohet ekzaminimit doganor, Posta Transitore e vendos shenjën "I nënshtrohet kontrollit doganor" dhe ia kthen dërgesën postës kompetente të zhdoganimit me fletëdërgesën postare doganore.

4. Nëse në Postën Transitore arrin dërgesa e pasaktë, për të cilën ka përfunduar procedura e zhdoganimit në eksport dhe përmbajtja e së cilës është e disponueshme, Posta Transitore në prani të zyrtarit doganor do të përpilojë procesverbalin P5 të brendshëm dhe do të ripaketojë dërgesën. Në mbështjellës rishkruhen të dhënat e dërgesës, pesha e re e përcaktuar dhe shënimi "Ri-ambalazhimi, të hapet nga komisioni në prani të marrësit". Dërgesa pas mbylljes, me një njoftim për pasaktësinë dhe dy kopje të procesverbalit CP8, procesverbal mbi mungesën e dërgesës kthehet në postën doganore kompetente.

5. Nëse në Postën Transitore arrin dërgesa, e cila nuk i është dorëzuar marrësit në vend, kurse i kthehet dërguesit jashtë vendit (retour), pa fletëdërgesën doganore postare, Posta Transitore e dërgon këtë dërgesë në postën kompetente të zhdoganimit, me njoftimin për pasaktësinë.

6.2.1. Dërgimi i dërgesave (thasëve postarë) nga Qendra Transite jashtë vendit

1. Të gjitha dërgesat postare të destinuara për eksport të ardhura nga Posta e Zhdoganimit, Qendra Transite ua dërgon postave të shteteve të jashtme në thasë të duhur.

Thasët postarë deklarohen në zyrën doganore kufitare gojarisht. Në rast se thasët postarë transportohen deri në pikën kufitare me automjete postare të mbyllura (të plumbuara), deklarohen në organin doganor kompetent sipas selisë së Postës Transitore.

2. Dërgesat me koli dërgohen në thasët postarë. Dërgesat e tilla deklarohen në Zyrën Doganore duke dorëzuar një kopje të Listës së këmbimit dhe fletëdërgesën doganore postare.

Në fletëdërgesën postare doganore shkruhen të gjithë thasët dhe paketat jashtë thasëve. Zyra Doganore pranë Postës Transitore vulos të katër kopjet e fletëdërgesës doganore postare. Kopjen e parë e ruan, tre të tjerat ia kthen Postës Transitore, e cila ruan një kopje dhe dy dërgesat e mbetura së bashku me thasët në Listën e shkëmbimit, si shtojcë.

3. Zyra Doganore kufitare e daljes, vulos fletëdërgesën doganore postare, ruan një kopje (me qëllim të shkarkimit dhe varësisht nga nevoja, ia dorëzon origjinalin ose fotokopjen Zyres Doganore në Postën Transitore, prej së cilës është dërguar fletëdërgesa doganore postare) dhe tjetrën e kthen në Postë. Në rast se thasët me koli deri në Zyrën Doganore Kufitare dërgohen me automjete të mbyllura (të plumbuara), vulosjen e fletëdërgesës postare doganore me rastin e dërgimit e bën Zyra Doganore në selinë e Postës Transitore, e cila i vendos automjetit pllumçen e Doganës.

4. Nëse thasët me koli dërgohen me avion, mënyra dhe procedura e dorëzimit të thasëve përcaktohen me marrëveshje ndërmjet Postës dhe transportuesit ajror.

Neni 7.

AUTOMATIZIMI DHE DIGJITALIZIMI I PROCESEVE GJATË KËMBIMEVE DHE KONTROLLIT TË DËRGESAVE

1. Automatizimi dhe digjitalizimi i proceseve, zgjerimi i gamës së produkteve dhe shërbimeve sipas standardeve të aprovuara në Rregullator (ARKEP) në secilën fazë të shërbimit postar, sistemi i automatizuar në përpunim dhe shpërndarje të letër postës dhe kolipostës/pakove sipas adresës së fundit të marrësit, grumbullim dhe dorëzim përmes sistemit të makinave të automatizuara 24/7, status, gjurmim në çdo kohë dhe mbyllje e qarkut postar.

2. Automatizimi dhe digjitalizimi përmes aplikacioneve softuerike me standarde të UPU-së për këmbimin e dërgesave postare në trafikun ndërkombëtar import/export sipas standardeve për gjenerimin e mesazheve ITMATT nga shkëmbimi elektronik i të dhënave EDI (Electronic Data Interchange) dhe të dhënave të avancuara elektronike EAD (Electronic Advanced Data), të nevojshme për të komunikuar informacionin e attributeve rreth dërgesave postare mes operatorit postar të origjinës që mbledh të dhënat dhe i transmeton në një mesazh ITMATT tek operatori postar i destinacionit për sigurinë e transportit dhe qëllime të zhdoganimit.

3. Implementimi i mjeteve të kontrollit skaner/detektor në parandalim dhe zbulim të mallrave të rrezikshme në përmbajtje të dërgesave postare në trafikun postar, implementimi i procedurave të zhdoganimit dhe kontrollit doganor për dërgesa në import dhe export përmes shërbimit postar bazuar në Marrëveshjen e mirëkuptimit (MoM), përmbushja e Procedurave Standarde të Operimit (PSO) në zhdoganimin e dërgesave postare me procedura të rregullta dhe të shpejta, implementimi i sistemeve elektronike për të shkëmbyer informacione midis Postës dhe Doganës, dhe përdorimi sistemeve të identifikimit automatik në përsheptimin e procesit doganor dhe dorëzim të shpejtë të dërgesave te klientët.

4. Ndërlidhja/komunikimi i aplikacioneve softuerike të Postës (SASP, IPS etj.) dhe (ASICUDA/World) nga Dogana për këmbimin e informatave elektronike me qëllim të arritjes së realizimit të këmbimit të informatave mes dy institucioneve, si dhe me operatorët tjerë postarë në përmbushje të mesazheve ITMATT dhe procedurave të ISC2, për mundësinë që çdo deklaram i kryer nga Posta të pasqyrohet automatikisht në sistemin e përpunimit të të dhënave doganore ASYCUDA World.

Neni 8

KONTROLLI I AKTIVITETEVE GJATË PËRDORIMIT TË APLIKACIONEVE TË POSTËS (SASP) DHE APLIKACIONEVE TË DOGANËS (ASYCUDA)

1. Gjatë kontrollit të aktiviteteve të përdorimit të aplikacioneve softuerike të Postës (SASP) dhe Doganës (ASYCUDA) do të zbatohet parimi me "Katër sy" si një mekanizëm i kontrollit të brendshëm, i cili kërkon që çdo aktivitet nga një individ brenda organizatës të kontrollohet, rishikohet dhe kontrollohet dyfish nga një individ i dytë që është kompetent dhe mbikëqyrës i personit, i cili plotëson të dhënat në aplikacionet softuerike të lartpërmendura.

2. Parimi me "Katër Sy" apo rregulli i kontrollit me dy persona do të zbatohet si masë për të rritur nivelin e sigurisë dhe transparencën, gjatë procesit të përpunimit të të dhënave (futjes, korrigjimit) në aplikacionet softuerike të Postës (SASP) dhe të Doganës (ASYCUDA).

3. Pas kalimit të ditës së futjes së të dhënave, në mënyrë që të lejohet ndryshim eventual i të dhënave në aplikacionin softuerik, do të bëhet Kërkesë e veçantë te Operatorit Ekonomik përgjegjës për krijimin dhe mirëmbajtjen e aplikacionit softuerik (SASP). Ndryshimet dhe korrigjimet e të dhënave do kryhen pas miratimit nga personit përgjegjës të Sektorit të Postës Doganore duke zbatuar kontrollin e parimit me "Katër sy".

Neni 9 KOMUNIKIMI

Gjatë procedurave të Implementimit të dispozitave të kësaj Rregulloreje në rast të konstatimit të shkeljeve të obligimeve ligjore të parapara me këtë Rregullore, nga ana e zyrtarëve të Postës së Kosovës ose të Doganës së Kosovës, menjëherë do të informohen menaxhmentet e nivelit të lartë të të dyja institucioneve me qëllim të inicimit të procedurave përkatëse disiplinore ndaj zyrtarëve përgjegjës dhe të marrjes së masave ligjore.

Neni 10 ZGJEDHJA E STAFIT

Posta e Kosovës do të zgjedhë stafin e saj në cilësinë e agentit doganor, të cilët do të trajnohen nga zyrtarët doganor dhe do të jenë përgjegjës për plotësimin e T1, Manifestit, Deklaratës Postare Doganore (DPD) dhe Deklaratës Unike Doganore (DUD) si dhe procedurave të tjera doganore për realizimin e procesit të zhdoganimit të dërgesave postare. I njëjti staf do të ketë qasje në përdorimin e aplikacioneve softuerike SASP dhe ASYCUDA.

Neni 11 HYRJA NË FUQI

Kjo rregullore fillon të zbatohet prej datës së aprovimit të Bordit të Drejtorëve të Postës së Kosovës, Sh.A. dhe zbatohet paralelisht me Udhezuesin për procedurën doganore në trafikun postar me Postën e Kosovës, nr.01/330/2024 dt.29.03.2024 të aprovuar nga Doganat e Kosovës.

Kryesuesja e Bordit të Drejtorëve të Postës së Kosovës SH.A.

Hyrmet Mydyti
